

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.102/2015, “PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, lidhur me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, ish-Ministria e Energjisë dhe Industrisë (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), me asistencën edhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Vjenë ka përgatitur një sërë projektaktesh, të cilët, pasi janë konsultuar edhe me institucionet e linjës, janë përcjellë për marrje mendimi në disa ministri, dhe më tej disa edhe janë miratuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Në këtë kuadër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në mbështetje të neneve 89 dhe 116, të ligjit nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ka përgatitur projektvendimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, që ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”.

Për këtë projektligj më parë, Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet shkresës së saj nr.7642/1, datë 1.12.2016, në pikën 1 të saj, është shprehur se “Baza ligjore e përdorur për nxjerrjen e këtij projektakti përbën autorizim në kuptim të nenit 118, të Kushtetutës, por për një akt me titull dhe përmbajtje tjetër”, duke patur në konsideratë referencën në pikën 2, të nenit 89, “Detyrimet e shërbimit publik”, të ligjit nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe më specifikisht në fjalinë e parë të kësaj ku shprehet se “2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit.. ERE, bazuar në kushtet e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, sipas interesit të përgjithshëm ekonomik, mund të vendosë mbi shoqëritë e gazit natyror detyrime të shërbimit publik, të cilat ...”.

Ndërkaq, vëmë në dukje se çështja e përcaktimit ligjor të furnizuesit me gaz të mundësisë së fundit, përfshihet tërësisht në nenin 90, “Furnizuesi me gaz natyror i mundësisë së fundit”, në pikën 1 të të cilit përcaktohet se: “1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit, bazuar në konkurrencën efektive,

mosdiskriminimin dhe transparencën.”. Ndërkohë, që në nenin 91 përcaktohen “Detyrimet e furnizuesit të mundësisë së fundit”.

Për më tepër, bazuar në këto përcaktime ligjore, për çështjen e “Furnizuesit me gaz natyror i mundësisë së fundit” në mbështetje të nenit 90, të ligjit nr.102/2015, është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurës për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit me gaz natyror.”.

Në këto kushte, duke vlerësuar në tërësi përmbajtjen e nenit 89, rezulton se është evidente që ky nen ka si objekt të qartë çështjen e detyrimeve të shërbimit publik (kjo nisur jo vetëm nga emërtimi i këtij neni, por gjithashtu edhe nga përmbajtja tërësore e tij). Me këtë arsyetim gjykojmë se përmbajtja e pikës 2, të nenit 89, konsiderohet si gabim/lapsus, ku fjalja e parë e këtij neni duhej të ishte formuluar “2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik.”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është planifikuar në programin analitik të projektakteve për vitin 2018, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me arsyetimin dhe argumentet si më sipër, duke vlerësuar në tërësi përmbajtjen e nenit 89, të ligjit nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, është evidente që përmbajtja e fjalisë së parë të pikës 2, të nenit 89, konsiderohet si gabim/lapsus, për sa ka të bëjë me shprehjen “miraton kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit”, pasi në këtë rast objekti i nenit 89 ka të bëjë me miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, gjë për të cilën do të duhet të bëhet ndryshimi përkatës në formulimin e fjalisë së parë të pikës 2, të nenit 89, të ligjit nr.102/2015.

Për këtë arsye, në ndryshimin që propozohet të bëhet në ligjin nr.102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kërkohet që fjalja e parë e pikës 2, të nenit 89, të ligjit nr.102/2015, të formulohet “2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik.”.

Miratimi i këtij ndryshimi në ligjin nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, do të krijojë mundësinë që nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të vazhdohet me procedimin e mëtejshëm të zbatimit të kërkesave të këtij ligji lidhur edhe me përfundimin e përgatitjes dhe më tej miratimin e projektvendimit “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e gazit natyror, që ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”, gjë e cila do të mundësojë edhe vazhdimin e praktikave të tjera në veprimtaritë lidhur me transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me gaz natyror.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me *acquis* BE-së.

Ndërkohë, vëmë në dukje se vet ligji nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, është përafruar me direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, e cila shfuqizon direktivën 2003/55/KE.

VI. PERMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Për sa me sipër, me anë të këtij projektligji propozohet ndryshimi dhe saktësimi i formulimit të fjalisë së parë, të pikës 2, të nenit 89, të ligjit nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, duke e përshtatur atë plotësisht me përmbajtjen e vet nenit 89, të ligjit që ka si objekt vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, në veprimtaritë lidhur me transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me gaz natyror.

Për këtë arsye, në ndryshimin/saktësimin që propozohet të bëhet në ligjin nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kërkohet që fjalia e parë e pikës 2, të nenit 89, të ligjit të formulohet “2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kushtet dhe procedurat për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik.”.

Me miratimin e këtij ndryshimi bëhet i mundur vazhdimi i mëtejshëm i procedurave për përgatitjen dhe miratimin e projektvendimit përkatës nga Këshilli i Ministrave.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për marrjen e masave për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.

KËSHILLI I MINISTRAVE